



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1574 Prot.
5

Tiranë, më 06/12/2013

Lënda: Urdhër për Kontrolluesin “Foto Studio Skënderbej”, Tiranë.

U R D H E R

Nr 25, datë 06/12/2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të Kontrolluesit “Foto Studio Skënderbej”, Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhrin nr. 223, datë 07.11.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye inspektimi administrativ pranë kontrolluesit “Foto Studio Skënderbej”, Tiranë me objekt:

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave “klient”:

- Mënyrat e mbledhjes, regjistrimit, përpunimit të të dhënave;
- Mjaftueshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të këtyre të dhënave përkundrejt qëllimit;
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi proces-verbalin e inspektimit administrativ, pretendimet e kontrolluesit, si dhe provat e administruara vëren se:

- Kontrolluesi mban dhe përpunon në kompjuter të dhënat personale të klientëve (fotot), për një afat të pacaktuar. Fotot e gjetura në kompjuter datojnë që prej vitit 2008 ose një apo dy vite më parë. (çka është konstatuar nga kontrolli në kompjuter).

Komisioneri vlerëson se mbajtja e të dhënave personale për një afat të pacaktuar bie në kundërshtim me shkronjën d) të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008

“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, në të cilin theksohet fakti se të dhënat personale nuk duhet të mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar (Parim i përgjithshëm i cili vlen në rastet kur nuk janë përcaktuar afate specifike nëpërmjet akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri). Duke qenë se qëllimi i mbledhjes dhe përpunimit lidhet me stampimin e fotografisë dhe më pas dhënien e tyre klientëve, atëherë nga ky moment përfundon afati i mbajtjes së fotove në kompjuter dhe ato duhet të fshihen. Mundësia e vetme ligjore për të mundësuar mbajtjen më tej të fotove është marrja e pëlqimit të klientëve në formë shkresore.

- Bazuar në deklaratat e përfaqësuesit të kontrolluesit, fotot mblidhen dhe mbahen në kompjuter me pëlqimin e klientëve por ky pëlqim nuk mund të provohet në formë të shkruar (shkronja a) e pikës1 të nenit 6, “Kriteret ligjore për përpunimin”, të ligjit). Komisioneri vlerëson se, në zbatim të dispozitës së sipërcituar, të dhënat personale mund të përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin. Ky është i vetmi parashikim ligjor që mund të lejojë këtë përpunim.

Dhënia e pëlqimit nga ana e subjektit të të dhënave (klientit) personale është shumë e rëndësishme pasi kjo vërteton dhe provon përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale (fotove). Në këtë kuadër kontrolluesit i lind detyrimi që të njoftojë subjektet e të dhënave mbi qëllimin e përpunimit, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe për të drejtat e detyrimet që parashikohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

- Sa i përket respektimit të kushteve mbi përpunimin e të dhënave personale të klientëve konstatohet se aksesit në kompjuter nuk realizohet nëpërmjet një fjalëkalimi të veçantë, por të dyja punonjëset aksesojnë me të njëjtin fjalëkalim. Gjithashtu kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme për përpunimin, mbledhjen ruajtjen e të dhënave personale që përpunon (detyrim i parashikuar në Udhëzimin nr.22, datë 24.09.2012 për “Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë të të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël”).

Në këtë kuadër komisioneri vlerëson se është shumë e rëndësishme që aksesit në kompjuter të kryhet nëpërmjet një emri/fjalëkalimi të veçantë për të dy punonjëset dhe në të njëjtën kohë të hartoet një rregullore e brendshme mbi përpunimin, mbledhjen, ruajtjen dhe fshirjen e të dhënave personale në të cilën të parashikohen të gjitha procedurat në lidhje me sa më sipër.

- Bazuar në deklaratimet e përfaqësuesit të kontrolluesit, u konstatua se shërbimet për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve kompjuterike realizohen nga një palë e tretë. Në këtë kuadër u konstatua se kontrolluesi nuk disponon një deklaratë sigurie dhe konfidencialiteti, lidhur me aksesin e mundshëm në të dhënat fotografi (të ruajtura në pajisjet kompjuterike) gjatë shërbimeve “hardware” dhe “software” të realizuara nga pala e tretë.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative :

URDHEROJ

1. Në zbatim të shkronjës c) të pikës 1 të nenit 5 dhe shkronjës a) të pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të fshihen nga kompjuteri dhe pajisjet e tjera të gjitha fotografitë e klientëve, pasi mbahen për një afat që e tejkalon qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar.
2. Të mbahen vetëm të dhënat personale (fotot) për të cilat është dhënë paraprakisht pëlqimi i shprehur qartë (në formë shkresore) i subjektit të të dhënave (klientit).
3. Të kufizohet aksesimi në kompjuter nëpërmjet vendosjes së një emri/fjalëkalimi të veçantë për të dy punonjëset.
4. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Udhëzimit nr. 22, datë 24.09.2012 për "Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë të të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël", të merren masa për hartimin e një rregullore të shkruar për mbledhjen përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale të klientëve. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
5. Në kuadër të realizimit të shërbimeve Hardware dhe Software të pajisjeve elektronike që përmbajnë foto, nga ana e palës së tretë, të parashikohet edhe një deklaratë kofidencialiteti dhe sigurie në të cilën të përcaktohen detyrime konkrete (për palën e tretë) në rast të cenimit të privatësisë.
6. Këto detyrimeve të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e marrjes dijeni për këtë urdhër;
7. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
8. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", sipas të cilit: "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

